REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1325 Prot. Maliq, më 02.03.2026

VENDIM
Nr.37, datë 27.02.2026

PËR "MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË MALIQ, 2026-2028"

Në mbështetje të ligj it nr. *139/2015 datë 17.12.2015,*"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të nenit 8 pika 1 dhe 2 ,nenit 9,pika 1, nënpika 1.1, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak"* gërma "k", neni 64 "*Detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë"*gërma"ç",VKM nr.859 datë 26.12.2024 për "*Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2024-2030",* "Planit të veprimit 2024-2026, Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për NJVV", grupi i punës i ngritur me vendim të Këshillit Bashkiak Maliq nr 118, datë 30.09.2025. Këshilli Bashkiak Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë Planin e Integritetit në Bashkinë Maliq 2026-2028, i hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe metodologjinë përkatëse. Dokumenti përfshin objektivat strategjikë, masat përkatëse, afatet e zbatimit dhe indikatorët e monitorimit.

2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, vecanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit të Bashkisë Maliq për veprime që mund të ndodhin dhe mund të cojnë në cënimin e integritetit të Institucionit.

3. Të gjitha strukturat, me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit, duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informata të një rëndësie të nevojshme për zbatimin e tij, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloren e brendshme të institucionit .

4. Njësitë përgjegjëse do të raportojnë çdo 6 muaj mbi progresin e zbatimit të masave të planit, ndërsa raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të bashkisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha strukturat drejtuese në bashki.

6. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar.

Miratuar me 20 vota
Vota Pro 20
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.3.2026

NË MUNGESË

DHE ME POROSI

ZV/KRYETARI I KËSHILLIT

Enida AVDOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

BASHKIA MALIQ

PLANI I INTEGRITETIT

2026-2028

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 37, Datë 27.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ORNILDI DEMOLLARI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

ENIDA AVDOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË BASHKINË MALIQ

1. Jonila	Xhialli,	Koordinatore e Grupit të Punës, Sekretare e Përgjithshme.
2. Almira	Muka,	anëtar (Drejtoresha e Financës e Buxhetit)
3. Gerilda	Rrapo	anëtar (Koordinatore e riskut, menaxhimit financiar dhe kontrollit)
4. Genci	Floqi,	anëtar (Drejtor Juridik dhe Çështjeve Ligjore)
5. Jona	Grabocka,	anëtar (Drejtoresha e të Ardhurave)
6. Afrim	Beqiraj,	anëtar (Pergjegjes Auditi i Brendshëm)
7. Enkelejda	Jonusllari,	anëtar (Drejtoresha e PKZHT)
8. Johand	Sula	anëtar (Drejtor i Pronave)
9. Ermanda	Petriti	anëtar (Drejtoreshë e Shërbimit Social)
10. Fatjon	Fasho	anëtar (Drejtor i Shërbimeve Publike)
11. Irsida	Polena	anëtar (Përgjegjëse Zyra e Integrimit Evropian)
12. Nertil	Çaushi	anëtar (Drejtor i Burimeve Njerëzore)
13. Andrea	Firanj	anëtar (Koordinator performance dhe bashkëqeverisje)
14. Stiljan	Belishta	anëtar (Pergjegjes Sektori Emergjencat Civile)
15. Devi	Mollaymeri	anëtar (Përgjegjës Sektori i Teknologjise dhe Informacionit)
16. Alfred	Pine ,	anëtar (Kryeinspektor ndërtimor)
17. Sadik	Halili,	anëtar (Inspektor Zjarrfikës)
18. Petrika	Note	anëtar (Kryeinspektor Policie)
19. Gertjan	Gjiriti	anëtar (Sekretar Keshilli Bashkiak)
20. Gentjana	Drabo	anëtar (anëtar KB, kryetar i grupit të mazhorancës)
21. Eglantina	Balli	anëtar (anëtar KB, kryetar i grupit të opozitës)

GRUPI I PUNËS AMVV

Ema Minxolli, Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të dhe Hartimit të Kurrikulave.

Renato Koxha, Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Majlinda Rriska, Eksperte e jashtëme

Ky plan integriteti është hartuar në kuadër të Komponentit "Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor" "Mbështetja dhe avancimi i reformave të qeverisjes vendore", në bashkëpunim me AMVV dhe me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Të frymëzuar nga vlerat e mirëqeverisjes, transparencës dhe përgjegjësisë publike si shtylla themelore të integritetit për ndërtimin e një administrate vendore të përgjegjshëme, që promovon dhe përmbush standardet e kërkuara në procesin e integrimit evropian, Bashkia Maliq vijoi me miratimin e Planit të Integritetit për vitet 2026-2028.

Ky plan është produkt i një procesi gjithëpërfshirës, ku strukturat tona të brendshme nëpërmjet një procesi vetëvlerësimi analizuan dhe vlerësuan monitorimin e planit të mëparshëm të integritetit i cili hodhi themelet e ushtrimit të detyrës publike me ndershmëri, paanshmëri, transparencë.

Plani i Integritetit 2026-2028 u hartua në përputhje me ligjin duke vendosur interesin publik mbi çdo interes personal apo politik, duke u bazuar në vlerat e mirëqeverisjes, transparencës. Në ndjekje të objektivave të mirëqeverisjes dhe ndërtimit të një administrate vendore të hapur, profesionale dhe etike, Bashkia Maliq shpreh përkushtimin e saj të plotë për zbatimin e këtij plani, dhe riafirmon përkushtimin për zbatim, si një hap konkret drejt një administrate të hapur dhe të ndershme që i shërben me dinjitet komunitetit që përfaqëson.

Integriteti, për ne, nënkupton ushtrimin e detyrës publike me ndershmëri, paanshmëri, transparencë dhe në përputhje me ligjin, duke vendosur gjithmonë interesin publik mbi çdo interes personal apo politik. Në thelb të misionit tonë qëndron bindja se besimi i qytetarëve është pasuria jonë më e madhe dhe se ky besim ndërtohet me veprime të matshme dhe të verifikueshme.

Kjo deklaratë përfaqëson zotimin tonë të përhershëm për të vepruar me integritet, për të forcuar llogaridhënien dhe për të ndërtuar një administratë vendore që u shërben të gjithëve me dinjitet, drejtësi dhe barazi.

Kryetar i Bashkisë Maliq

Gëzim Topçiu



SHKURTESA

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BNJ	Burime Njerëzore
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
GPI	Grupit të Punës për Integritetin
KI	Konflikti i Interesit
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PI	Plani i Integritetit
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
PSV	Procedura Standarde Veprimi
OGP	Parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Rëndësia e Planit të Integritetit 6
1.1 Hartimi i Planit të Integritetit 6
1.2 Qasja metodologjike 7
2. Objektivat e identifikuara dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit 9
3.Buxhetimi i Masave Prioritare 9
4.Plani i veprimit 10

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Plani i Integritetit paraqet një mjet apo mekanizëm të rëndësishëm për forcimin e integritetit institucional. Ai është një dokument strategjik dhe operacional, i cili është produkt i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit. Plani i Integritetit 2026–2028, vijon dhe përmirëson përvojën e akumuluar nga Plani i parë i Integritetit 2022–2025, i cili ishte iniciativa e parë e bashkisë për menaxhimin e riskut të integritetit në nivel vendor.

Gjatë ciklit të parë të zbatimit 2022–2025, Bashkia Maliq realizoi një sërë masash të rëndësishme, përfshirë:

- forcimin e rolit të Koordinatorit të Integritetit,
- trajnime bazë mbi etikën për stafin e brendshëm,
- ngritjen e disa praktikave për transparencën e vendimmarrjes në Këshillin Bashkiak
- publikimin e disa dokumenteve bazë të menaxhimit financiar.

Megjithatë, zbatimi i planit të mëparshëm u përball me disa kufizime, përfshirë mungesën e matjes së performancës për secilën masë, mungesën e një skeme monitorimi dhe përfshirjes së aktorëve të jashtëm, si dhe mungesën e harmonizimit të masave me indikatorë të matshëm të riskut. Në këtë kuadër, plani i ri për periudhën 2026–2028 synon të kapitalizojë përvojën ekzistuese, duke vendosur një sistem të integruar menaxhimi të riskut të integritetit, përfshirë mekanizma për vlerësim, pjesëmarrje dhe transparencë të qëndrueshme, si dhe një qasje më të strukturuar për monitorim dhe raportim periodik

Plani i Integritetit 2026-2028, si një instrument menaxhimi për parandalimin e korrupsionit u hartua duke u bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të monitorimit të planit të mëparshëm i cili hodhi themelet në drejtim të: krijimit të standardeve etike në institucion; rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore për cështjet e integritetit; përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies publike, forcimit të rolit të koordinatorit të integritetit, si dhe duke marë në konsideratë risqet e mbetura dhe vlerësimin e risqeve të reja të integritetit.

1.1Hartimi i Planit të Integritetit 2026-2028 u bazua në:

1.Kuadrin bazë të politikave kundër korrupsionit si:

- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe Plani i Veprimit 2024–2026
- Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030 dhe plani i saj i veprimit 2023-2025;

- Rekomandimet e GRECO-s (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) për forcimin e integritetit në nivel vendor;
- Parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP Local), të cilat sigurojnë pjesëmarrje të gjerë qytetare, transparencë dhe llogaridhënie;
- Aktetet ligjore dhe nënligjore bazë për qeverisjen Vendore.
- Aktet e reja nënligjore në fushën e etikës transparencës, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes vendore.

1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Maliq

Hartimi i Planit u realizua nga një Grup Pune i ngritur me vendim keshilli bashkiak nr 118 date 30.09.2025 dhe urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr.49 ,datë 30.01.2026 i përbërë nga përfaqësues të administratës, të cilët u asistuan, nga ekipi i punonjësve dhe ekspertëve të AMVV.

Hartimi i Planit të Integritetit u bazua në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore e cila ofron një model të unifikuar për identifikimin, vlerësimin dhe prioritarizimin e risqeve në proceset vendore. Kjo metodologji bazohet në shtatë shtylla të integritetit: Financat dhe Kontrolli, Buxheti dhe Prokurimi Publik, Administrimi i Pronës Publike, Burimet Njerëzore, Planifikimi Urban, Shërbimet Publike dhe Kontrolli i Brendshëm.

1.2 Qasja Metodologjike

Hartimi i Planit të Integritetit u bazua në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore e cila ofron një model të unifikuar për identifikimin, vlerësimin dhe prioritarizimin e risqeve në proceset vendore. Kjo metodologji bazohet në shtatë shtylla të integritetit: Financat dhe Kontrolli, Buxheti dhe Prokurimi Publik, Administrimi i Pronës Publike, Burimet Njerëzore, Planifikimi Urban, Shërbimet Publike dhe Kontrolli i Brendshëm.Hartimi i Planit të Integritetit 2026-2029 u realizua në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e riskut në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, duke ndjekur një qasje të kombinuar cilësore dhe sasiore.

1. Hapi 1 – Vlerësimi Cilësor

U zhvillua përmes:

- Fokus-grupeve në nivel drejtorish;
- Analizës së kuadrit të brendshëm rregullator;

Analiza u udhëhoq nga modeli i "7shtyllave të integritetit":

1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli
2. Buxheti & Prokurimi Publik;
3. Administrimi i Pronës Publike;
4. Burimet Njerëzore;
5. Planifikimi Urban;
6. Shërbimet Publike;
7. Kontrolli i Brendshëm.

Gjatë fokus grupeve u trajtuan risqet dhe problematikat që mund të përbëjnë risk për integritetin gjatë praktikës së punës, si dhe nevojat për trajnim dhe kualifikime shtesë, apo mangësi në burimet financiare.

2. Hapi 2 – Vlerësimi Sasiore

U realizua përmes një anketimi elektronik me 44 punonjës (kampion përfaqësues i të punësuarve aktivë në bashki), duke garantuar në nivel besueshmërie 95 %. Pyetësori i strukturuar me indikatorë matës për perceptimet mbi:

- Konfliktin e interesit;
- Transparencën ;
- Respektimin e Kodit të Sjelljes dhe etikë;
- Efikasitetin e vlerësimit dhe të performancës;

Ky instrument ka për qëllim të matë perceptimet e nëpunësve të bashkisë lidhur me funksionimin dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Pyetësori përfshin pyetje të fokusuara në çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në administratën e bashkisë, u plotësua në mënyrë anonime për të garantuar lirinë e shprehjes dhe besueshmërinë e rezultateve. Procesi i anketimit përfshiu një kampion prej 44 nëpunësish bashkiakë, bazuar në parimin e përzgjedhjes dhe raportimit vullnetar nga stafi.

Nga aspekti gjinor, zyrtarët meshkuj përbëjnë 39 % të kampionit, ndërsa zyrtaret gra përfaqësojnë 61 %. Sa i përket grupmoshave, kategoria më e përfaqësuar është ajo e moshës 36-45 vjeç 41%, e ndjekur nga grupmosha 26-35 vjeç 39%. Grupmoshat 46-55 vjeç 5 % dhe mbi 56 vjeç përbëjnë përkatësisht 9 % të kampionit, ndërsa nëpunësit deri në moshën 25 vjeç përfaqësojnë vetëm 6 %.

Në aspektin e përvojës profesionale, nëpunësit me më pak se 5 vite përvojë pune përbëjnë 16 % të kampionit. Kategoria me 5-10 vite përvojë përfaqëson 68 %, ndërsa nëpunësit me 11-20 vite përvojë përbëjnë 16 %. Grupet me 21-30 vite përvojë përbëjnë 0 % të kampionit, ndërsa grupi me mbi 30 vite përvojë pune përbën vetëm 0 %.

Plani i Integritetit do të fillojë zbatimin pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

2. Objektivat e identifikuara.

2.1 Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

2.2 Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki.

2.3 Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies , si dhe efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë;

3.Buxhetimi i Masave Prioritare (Model)

Duke respektuar tavanin ligjor të përcaktuar në SNKK, që shpenzimet për integritet të mos tejkalojnë **1 %** të buxhetit paketa e konsoliduar e masave për 3 objektivat kërkon rreth 4.5 **milionë lekë** në vitin e parë, ose 28.3% të buxhetit total. P.sh.

Blloku i masave	**Totali 3 vjet**	**Operim vjetor (lekë)**	**Totali vit 1**
OS-1 – *Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator*	6.5 mln	3.9 mln	3.4 mln
OS-2 – *Forcimi i kuadrit rregullatodhe strategjik i etikes dhe integritetit;*	0.46 mln	0.46 mln	0.3 mln
OS-3 – *Forcimi i transparencës, fushat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike;*	9 mln	5.2 mln	0.8 mln
TOTAL	**15.96 mln**	**9.56 mln**	**≈ 4.5 mln**

Si u përllogaritën kostot?

- **Investimet** (6.5 mln lekë) përfshijnë shpenzimet kapitale një-herëshe: platforma digjitale (OCDS, GIS, e-learning,…..), modernizim serverash, rishikim përshkrimesh pune, paketë orientuese etj.
- **Operimi** (9.5mln lekë/vit) mbulon trajnimet periodike, forumet "Ditët e Hapura", Buxhetimin me Pjesëmarrje, sondazhin e, skemën "….." dhe mirëmbajtjen e sistemeve digjitale.

Në buxhetet pasuese, vetëm komponenti operativ (~ 9.5lekë/vit) përsëritet, ndërsa kostot kapitale amortizohen. Me shpenzime prej 1.2 % të buxhetit, Bashkia mund të lërë **2 milionë lekë** hapësirë si fond kontingjence për masa të reja ose kosto të paparashikuara gjatë zbatimit.

4.Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuara sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë . Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Procesi i zbatimit dhe monitorimi bazohet në "Metodologjinë për Monitorimin e Planeve të Integritetit" dhe duhet të ndërthur vetëvlerësimin institucional me verifikimin nga jashtë.Ky sistem synon të sigurojë që progresi ndaj objektivave të Planit të Integritetit (PI) të matet në mënyrë të rregullt, transparente dhe të krahasueshme në kohë. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili ndjek progresin e zbatimit.

Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore. Raportimi i lejon titullarit të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Koordinatori përgatit raportin përmbledhës vjetor dhe pas miratimit nga Kryetari, ai publikohet në faqen zyrtare të bashkisë dhe i dërgohet AMVV-së.

	Objektivi 1: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit					
Nr.	**Risku dhe ngjarjet e mundshme**	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve	Buxheti Indikativ (leke)
1	Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk është e përditësuar me strukturën aktuale të bashkisë.	Operacionet (Procesi)	I Mesëm	1.Përditësimi (dhe miratimi) i rregullores së bashkisë me strukturën aktuale. 2. Përcaktimi i plotë dhe i qartë në rregullore i detyrave dhe linjave të komunikimit dhe hierarkisë ndërmjet strukturave të bashkisë.	Kryetari/Grup Pune Gjashtëmujori i dyte 2026.	1360000
2	Përditësimi i Kodit të Sjelljes dhe Etikës për administratën e bashkisë	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	I Mesëm	1.Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për administratën e bashkisë, duke përfshirë rregulla në lidhje me parandalimin dhe deklarimin e konfliktit të interesit, veprimtarive të jashtme, pranimit dhe deklarimit të dhuratave, si dhe deklarimit të pasurisë.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria Juridike Gjashtëmujori	323360

				2. Informimi i personelit të bashkisë lidhur me Kodin e ri të Sjelljes dhe Etikës.	i pare i vitit 2026	
3	Mungesë informacioni i përditësuar mbi regullat e etikës dhe integritetin për stafin e bashkisë .	Operacional/procesi	I Lartë	1.Hartimi i kalendarit të trajnimeve për stafin. 2. Hartimi i moduleve të trajnimit.	Drejtoria BNJ, & IT Gjashtëmujori i dytë 2026.. e në vijimësi.	50390
4	Mungesë e njohjes së rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike në bashki nga stafi.	Operacional	Mesatar	1. Përditësimi i Rregullores se Brendshme të KI (p.sh zgjerimi i subjekteve për të cilët zbatohet kjo rregullore duke përfshirë edhe anëtarët e KB etj.) 2. Publikimi i rregullores së rishikuar. 3. Trajnime për personelin e Bashkisë dhe anëtarët e KB për përmbajtjen e kësaj rregulloreje dhe akteve mbështetëse.	1.Drejtoria e e Burimeve Njerëzore Autoriteti Përgjegjës për Konfliktin e Interesit në Bashki + Punonjësi i I.T. Gjshtëmujori i dytë 2026 e në vijimësi.	40000
5	Përditësimi i njohurive të personelit të bashkisë, në lidhje me procedurat e sinjalizimit të parashikuara në ligj dhe në Rregulloren e Posaçame të Bashkisë për	Operacional / Reputacioni	Mesatar	1. Realizimi i trajnimeve të domosdoshme për procesin e hetimit dhe shqyrtimit administrativ të sinjalizimeve për praktika apo veprime të dyshuara	Sektori i Auditit të Brendshëm Gjashtëmujori i pare i 2026.	11982

	Sinjalizimin.			korrupsioni, për stafin e AB-së, të ofruara nga ASPA apo ILDKPKI. 2. Rikujtesë periodike e punonjësve mbi funksionin dhe kontaktin e sinjalizuesit. 3. Publikimi i rregullores në PT-në e bashkisë.	dhe në vijimësi	
6	Hartimi i Regjistrit të Menaxhimit te Riskut mbi baza objektive nga te gjitha drejtoritë.	operacional/ Strategjik	Mesatar	1. Rishikimi i Regjistrit të Riskut nga të gjitha drejtoritë. 2.Trajnim i personelit lidhur me metodologjine e hartimit të Riskut.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Ekonomisë. Gjashtëmujori i parë i 2026. e në vijimësi	818250
7	Mungesa e PSV-ve dhe gjurmëve të auditimit për të gjitha llojet e auditimit të kryer.	Operacional/ Procesi	I Larte	1. Hartimi i një plani për zhvillimin e PSV-ve dhe gjurmëve të auditit për të gjitha llojet e auditimit.	Njësia e Auditit të Brendshëm Gjashtëmujori i dytë 2026	818250
8	Mungesa e rregullave dhe treguesve për procesin e mbikëqyrjes dhe monitorimit të performancës së shërbimit.	Operacional/ Procesi	I Larte	1. Ngritja e një grupi pune me urdhër të titullarit, për hartimin e standardeve të cilësisë për cdo shërbim. 2. Hartimi i standardeve të	Drejtoria e Shërbimeve Publike/Grupi i Punes për Hartimin e	500320

				administrimit të performancës. 3. Publikimi i instrumentit të miratuar dhe treguesve përkatës të performancës në PT-në e bashkisë.	Standardeve të Cilësisë së Shërbimeve Gjashtëmujori i dytë 2027 e në vijimësi.	
9	Mungon Plani Strategjik i Zhvillimit ekonomik të Bashkisë.	Operacional/ Strategjik	1 Lartë	1. Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të BashkisëP. 2. Publikimi i këtij plani në Programin e Transparencës.	Grup Pune për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik Koordinatori për të Drejtën e Informimit Gjashtëmujori i dytë .2028.	2500000

	Objektivi 2: Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki;					
Nr.	**Risku dhe ngjarjet e mundshme**	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve	
11	Mungesa e një plani vjetor trajnimesh të brendshme, i cili adreson nevojat profesionale të personelit të bashkisë.	Burimet Njerezore/Operacional	Mesatar	1. Përcaktimi në rregulloren e brendshme i detyrimit për hartimin e Planit të Brendshëm Vjetor të Trajnimeve. 2.Përcaktimi në rregulloren e brendshme i detyrimit për kryerjen e Analizës Vjetore të Perfomancës, si bazë për identifikimin e nevojave për trajnim dhe hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve. 3. Hartimi i Planit të Brendshëm të Trajnimeve dhe Analizës së Performancës, çdo vit. 4. Caktimi i një personi përgjegjës pranë DBNJ-së për trajnimet e personelit.	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike Grupi i punës i caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë për rishikimin e rregullores. Gjashtëmujori i dytë i 2026 e në vijimësi	50390
12	Mungesa e një plani vjetor trajnimesh specifike teknike bazuar në kërkesat e drejtorive.	Operacional	Mesatar	1.Hartimi i Planit të vjetor të Trajnimeve sipas nevojave të drejtorive.	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	40000

				2.Përcaktimi i një buxheti të dedikuar për trajnimet specifike.	Gjashtëmujori i dytë 2027	
13	Dosjet e personelit mbahen në formatin fizik dhe atë excel për shkak të mungesës së aksesit në sistemin HRMIS.	Operacionet (Procesi)	Mesatar	1.Komunikimi nëpërmjet kërkesës zyrtare me Departamentin e Administratës Publike për përditësimin e të dhënave të punonjësve në systemin HRMIS.	Burimet Njerëzore Gjashtëmujor i dytë 2027 e në vijimësi.	40000 eksperte
14	Nevojë për trajnime të vazhdueshme mbi ndryshimet e shpeshta ligjore/nënligjore në fushën e prokurimit publik.	Burime Njerëzore/ Operacional	I Larte	1. Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me ASPA-n dhe APP.	Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Burimeve Njerëzore/ Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Gjashtëmujori parë i 2026 e në vijim.	15000
15	Punonjësit nuk janë të trajnuar mbi monitorimin dhe standardet e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike.	Burime Njerëzore/ Operacional	I Mesëm	1. Marrja e masave për trajnimin e punonjësve lidhur me standardet e cilësisë dhe monitorimin e ofrimit të shërbimeve publike.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i parë i 2026	61820
	Mungesë e burimeve njerëzore të	Burime	I Larte	1. Plotësimi i vakancave për	Drejtoria e	50000

16	specializuara në sektorin përgjegjës për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit.	Njerëzore/ Procesi		burme njerëzore të specializuara në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit.	Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i dytë i 2026	
17	Nevojë për njohuri shtesë të punonjësve te njësisë së integrimit evropian lidhur me procedutat e aplikimit për përfitimin e projekteve nga B.E	Burime Njerëzore/ Procesi	I Mesëm	1.Ofrimi i trajnimeve të personelit në këtë fushë.	Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i dytë 2026 e në vijimësi	200000

	Objektivi 3. Forcimi i transparencës, llogaridhënies publike dhe efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë të bashkisë;					
Nr.	**Risku dhe ngjarjet e mundshme**	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve	
18	Mungesë e një mekanizmi që mat perceptimin publik indeks vjetor i besimit publik.	Operacional/Procesi	I Mesëm	1.Pregatitja e pyetsorit; 2.Kryerja e sondazheve; 3.Analiza dhe publikimi i rezultateve.	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për të drejtën e informimit Gjashtëmujori i dytë i vitit 2027 e në vijimësi.	310000
19	Pjesëmarrje e ulët e të rinjve në aktivitete/vendimmarrjet e bashkisë	Operacional/Procesi	I Mesëm	1.Përfshirja e të rinjve në aktivitetet e bashkisë, Këshillir Bashkiak dhe ftesa në konsultimet publike të realizuara. 2.Organizimi i fushatave ndërgjegjsuese për pjesmarrjen active	Koordinatori për konsultim dhe informim public, Sekretari i Këshillit Bashkiak. Integritet, Forumi OGP Gjashtëmujori I pare 2027 e në vijim	300000

				Rininë në vendimarrje.		
20	Regjistri i kontratave për pronat në pronësi ose administrim të Bashkisë nuk është publik.	Operacional/Procesi	I Mesëm	1.Publikimi i regjistrit të kontratave dhe marrveshjeve për pronat në administrim të Bashkisë në faqen zyrtare të bashkisë.	Drejtoria përgjegjëse e Pronave/ Koordinatori për të Drejtën për Informim Gjashtëmujori i parë i 2027	10500
21	Mungesë e informacionit publik për donacionet e bashkisë në PT.	Operacional/Procesi	I Mesëm	1. Hartimi periodik i raporteve gjashtëmujore mbi të gjithë donacionet e përfituara nga bashkia (jo vetëm për bashkëfinancimet me fonde të IPA-së) sipas kërkesave të Rregullores së Këshillit Bashkiak. 2. Publikimi në PT, i informacionit për donacionet e përfituara nga bashkia, duke	Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar + Koordinatori I Njësisë së Integrimit Evropian. Koordinatori për të Drejtën e Informimit Gjashtëmujori i dytë 2027	75000

				përfshirë emrin e donatorit, shumën e donacionit, qëllimin e donacionit.		
22	Pjesëmarrje e ulët e qytetarëve në vendimmarrje financiare	Strategjik/operacional	I Larte	1.Publikim ftesash; 2.votim online; 3.monitorim projektesh	Drejtoria Financë & Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, Koordinatori i Performancës, Forumi OGP Gjashtëmujori pare 2027…. e në vijimësi	75000

23	Rritja e nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të auditit të brendshëm dhe të jashtëm KLSH nga ana e drejtorive të bashkisë.	Burimet Njerëzore / Strategjik	I Larte	informuese me personelin e drejtorive në lidhje me rolin e auditit të brendshëm dhe detyrimet e secilës drejtori. 2. Kryerja e një analize vjetore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga të gjitha institucionet audituese (të brendshme dhe të jashtme) 3.Përcjellja e kësaj analize tek kryetari i bashkisë.	Grupi i Punës për rishikimin e rregullores + Sektori i Auditit të Brendshëm Gjashtëmujori i parë 2027 e në vijimësi.	
24	Mungesa e një sistemi elektronik të qendërzuar për procesin e inventarizimit të aseteve në bashki.	Operacional / Financiar	I Mesëm	1. Krijimi i një sistemi elektronik të qendrëzuar me informacion të përditësuar për inventarizimin e aseteve në bashki me akses të personelit të përfshirë në procesin e administrimit dhe menaxhimit të pronave të bashkisë 2. Hartimi dhe miratimi i një PSV-je për të rregulluar mënyrën e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të qendërzuar. Përcaktimi i detyrimeve të drejtorive për shkëmbimin e informacionit në lidhje me asetet e bashkisë.	Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve + Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar + Sektori i Administrimit të Rjetit Kompjuterik dhe Informacionit Digjital Gjashtëmujori i parë 2028 e në vijimësi.	3000000
25	Dokumentat Financiare Arkivore nuk jane te digjitalizuara.	Teknologjia e Informacionit	I Mesëm	1. Marrja e masave për digjitalizimin e fondit arkivor të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Gjashtëmujori i pare i vitit 2028.	3000000
26	Detyrime të papaguara të prapambetura ndaj	Operacionet (Procesi)	I Mesëm	1.Ndjekja e procedurave ligjore për të siguruar arkëtimin	Financa	230000

	bashkisë nga të tretët.			e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore.	Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijimësi	
27	Mungesë e një plani afatgjatë strategjik për mirëadministrimin e pronave.	Operacionet (Procesi)	I Larte	1.Hartim i strategjisë/Planit për vënien në përdorim të aseteve vendore, duke përfshirë burimet financiare dhe dhe politikat fiskale që mbeshtesin zbatimin e strategjisë/planit. 2.Publikimi i tij në faqen zyrtare të bashkisë.	Grup Pune Gjashtëmujori i parë 2028..	500000
28	Mungesë e një databaze elektronike të pronave bashkiake.	Procesi	I Mesëm	Skanim titujsh; GIS entry; test	Drejtoria Pronave & Drejtoria TI– Q4/ Gjashtemujori I pare 2026	50000
29	Plani i Përgjithshëm Vendor ekzistues ka nevojë të përditësohet.	Operacional/ Strategjik	I Mesëm	1. Te vlerësohet mundesia e rishikimit dhe ripunimit te Planit te Pergjithshem Vendor, në mënyrë që të reflektojë nevojat dhe vizionin aktual të bashkisë. 2. Te sigurohet konsultimi publik i PPV-së së rishikuar me qytetarët e bashkisë.	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve/Koordinatori për konsultimin publik Gjashtëmujori i dyte i 2028.	500000
30	Mungesa e Planeve të Detajuara Vendore sipas prioriteve në përputhje me Planin e Përgjithshëm vendor	Operacionet (Procesi)	I Mesëm	1. Hartimi i planit të detajuar vendor sipas parashikimeve të bëra në Planin e përgjithshëm vendor.	Grup Pune Gjashtëmujori i dytë 2028.	500000

	të përditësuar për bashkinë.			2. Të kryhet konsultimi publik me te gjithe aktoret publike te interesuar, sipas dispozitave te Ligjit Per Njoftimin dhe Konsultimin Publik.		
31	Mundësi të kufizuara për zhvillimin e pronave si pasojë e mungesës së mjeteve financiare që duhen për procesin e hipotekimit.	Operacional/Financiar	I Larte	1. Buxhetimi dhe parashikimi i fondeve të nevojshme për finalizimin e hipotekimit të pronave duke filluar fillimisht me ato prona të cilat mund të përdoren për investim dhe të gjenerojnë të ardhura. 2. Bashkëpunimi me ASHK dhe vlerësimi i mundësisë së lehtësimit të formave të pagesës për regjistrimin e titujve të pronësisë në favor të NJVV . 3.Hartimi i një PSV për krijimim e linjave të qarta të komunikimit/rakordimit për procesin e hipotekimit.	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit/Sektori i Planifikimit, Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe Pronave Gjashtëmujori i parë i 2026 e ne vazhdim.	500000